FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 189

Tiranë – E mërkurë, 27 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 367, datë 20.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	22489
Dekret i Presidentit nr. 368, datë 20.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	22489
Dekret i Presidentit nr. 369, datë 20.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	22489
Dekret i Presidentit nr. 370, datë 20.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	22490
Dekret i Presidentit nr. 374, datë 20.12.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	22490
Dekret i Presidentit nr. 375, datë 20.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	22490
Dekret i Presidentit nr. 376, datë 20.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	22491
Dekret i Presidentit nr. 377, datë 20.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	22491
Dekret i Presidentit nr. 378, datë 20.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	22491
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 167, datë 13.12.2023	Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e disa aspekteve të procedurës së licencimit të sipërmarrjeve hekurudhore".....	22492
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 169, datë 13.12.2023	Për miratimin e rregullores "Për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore".....	22501

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 170, datë 13.12.2023	Për miratimin e rregullores "Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë".....	22514
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 63, datë 20.11.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 786 (3491), datë 28.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 113, datë 15.2.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe/ose kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me tjetër trup gjykues.....	22519

DEKRET
Nr. 367, datë 20.12.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Gentian Tomi Lila (Bardhi)
2. Mereme Abaz Dimitriou (Cani)
3. Dionisia Evangjellos Kapsalidhi
4. Anjeza Maksim Kullolli
5. Aaron Edmond Leka
6. Lionel Edmond Leka
7. Lukas Edmond Leka
8. Beniamin Mino Çani
9. Edison Edmond Zani
10. Vjollca Xhelal Hysa (Rami)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 368, datë 20.12.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13 dhe 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Maria Ilir Hajdarmataj
2. Armilda Mihallaq Laçkaj
3. Brigjida Filip Mazi (Krasniqi)
4. Dorjana Ylli Dagistani
5. Tila Rami Schober (Keko)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 369, datë 20.12.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13 dhe 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Gloria Halil Doçi
2. Erjon Jusuf Tufina
3. Ornela Qamil Grëmi
4. Klodian Rushit Hazizaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 370, datë 20.12.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13 dhe 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Ervina Halil Xhika
2. Tina Haziz Shahini
3. Valbona Ferik Kadiu (Leba)
4. Drita Llesh Korbi
5. Sllafka Peko Rajçeviq (Hajkoja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 374, datë 20.12.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Odesa Arqile Dylgjeri
2. Antonin Arben Hoxha
3. Franc Kolë Bushati
4. Arbër Gjergj Lleshaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 375, datë 20.12.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Ajaz Parim Ajazaj
2. Agim Adem Bekaj
3. Xhanije Ilaz Ajazaj (Kryeziu)
4. Lindjeta Flurim Morina
5. Rizan Vezaj (Xhoxhaj)
6. Selim Idriz Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 376, datë 20.12.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6 dhe 20, e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Drita Miftar Gjuraj (Maçi)
2. Rrahim Qazim Kolukaj
3. Shkumbin Durmish Rizvanolli
4. Elma Blerim Rrahmani Bajra

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 377, datë 20.12.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Melos Kujtim Dinarama
2. Haki Amet Gutaj
3. Blerton Haki Gutaj
4. Dugagjin Murat Kabashi
5. Beqë Mustafe Rexha
6. Behajdin Nezir Rexha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 378, datë 20.12.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Shyqerije Bajram Rrahmani (Bytyqi)
2. Ervin Blerim Rrahmani
3. Remzije Selim Sadikaj (Kadriaj)
4. Sehla Besnik Demiri (Dauti)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 167, datë 13.12.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E DISA ASPEKTEVE TË PROCEDURËS SË LICENCIMIT TË SIPËRMARRJEVE HEKURUDHORE"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të neneve 17 deri në 26, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare"',

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e disa aspekteve të procedurës së licencimit të sipërmarrjeve hekurudhore", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Rregullorja nr. 2638, datë 10.6.2011, "Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhorë", shfuqizohet.
3. Ngarkohet Autoritetit Licencues Hekurudhor dhe sipërmarrësit hekurudhorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E DISA ASPEKTEVE TË PROCEDURËS SË LICENCIMIT TË SIPËRMARRJEVE HEKURUDHORE[1]

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi, disiplinimi dhe monitorimi i veprimtarisë së sipërmarrësve hekurudhor për integrimin gradual të tyre në tregun evropian të transportit hekurudhor.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i aspekteve të procedurës për dhënien e licencës për ofrim shërbimesh në sektorin hekurudhor dhe caktimi i detajeve për përdorimin e një modeli të përbashkët të licencës.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimin e kësaj rregulloreje, "licencë" nënkupton modelin e përbashkët për veprimtari në transportin hekurudhor, të plotësuar dhe të nënshkruar siç përcaktohet në aneksin I dhe II, të kësaj rregulloreje, për t'u dorëzuar pranë Agjencisë Evropiane të Hekurudhave.

Neni 4
Përdorimi i formatit të përbashkët për dokumentin e licencës

1. Licencat e lëshuara në përputhje me kreun II, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", janë sipas formatit standard të përcaktuar në aneksin I dhe II të kësaj rregulloreje.
2. Në rastin kur lëshohet një licencë e re, autoriteti licencues vendos numrin e njoftimit të licencës KE, në përputhje me sistemin e harmonizuar të numërimit të quajtur Numri Evropian i Identifikimit (NEI).

[1] *32015R0171, rregullore zbatuese e Komisionit BE 2015/115, e datës 4 shkurt 2015, "Për disa aspekte të procedurës së licencimit të ndërmarrjeve hekurudhore", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 29/3, datë 5.2.2015.*

3. Sa herë që jepet një licencë, ndryshohet, pezullohet, revokohet ose zëvendësohet nga një licencë e përkohshme, autoriteti licencues krijon një licencë bazuar në këtë format.

4. Autoriteti licencues informon Agjencinë Evropiane të Hekurudhave, në përputhje me pikën 8, neni 25, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", duke siguruar një kopje të dokumentit të licencës siç përcaktohet në protokollin e komunikimit të rënë dakord ndërmjet tyre.

5. Informacioni në lidhje me mbulimin financiar për përgjegjësinë civile të përmendur në nenin 23, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", do të deklarohet në aneksin e dokumentit të licencës, duke përdorur formatin standard të përcaktuar në aneksin II të kësaj rregulloreje. Autoriteti që lëshon licencën i bashkëngjit një aneks dokumentit të licencës. Kësaj shtojce i jepet numri një (1).

6. Nëpërmjet informacionit të dhënë në anekset e përgjegjësisë, siç përcaktohet në aneksin II të kësaj rregulloreje, autoriteti licencues ose një administrator infrastrukture kontrollon nëse mbulimi i përgjegjësisë civile, i marrë nga sipërmarrja hekurudhore, është i mjaftueshëm. Nëse autoriteti licencues konstaton se niveli i mbulimit është i pamjaftueshëm, ai i kërkon sipërmarrjes hekurudhore të marrë mbulim shtesë. Sipërmarrja hekurudhore i siguron autoritetit licencues informacionin e kërkuar në lidhje me mbulimin e tij.

7. Pasi autoriteti licencues konstaton mbulim të plotë, ai informon Agjencinë Evropiane të Hekurudhave, duke përditësuar një aneks ekzistues ose duke shtuar një aneks të mëtejshëm në licencë, duke përdorur formatin standard të këtij aneksi II dhe cakton numrin e radhës (2, 3, 4, etj.) në këtë aneks.

8. Çdo aneks përmend shumën, shtrirjen gjeografike ose llojet e shërbimeve, datën e fillimit dhe të mbarimit. Numri i njoftimit të licencës përmendet në çdo aneks për të krijuar një lidhje të qartë me sipërmarrjen hekurudhore të licencuar. Autoriteti licencues krijon një aneks të përditësuar kur informohet për një ndryshim në mbulimin e përgjegjësisë civile dhe ia komunikon aneksin Agjencisë Evropiane të Hekurudhave.

Neni 5

Disa aspekte që kanë të bëjnë me kërkesat për mbulimin e përgjegjësisë civile dhe garancitë e përshtatshme

1. Autoriteti licencues publikon nivelet minimale të kërkuara të mbulimit, duke përfshirë edhe kur shuma e një mbulimi të tillë përcaktohet në legjislacionin kombëtar.

2. Autoriteti licencues nuk mund të kërkojë që mbulimi të hyjë në fuqi përpara se sipërmarrja hekurudhore të fillojë funksionimin e saj të trenave.

3. Autoriteti licencues që ka lëshuar licencën kërkon nga të gjitha sipërmarrjet hekurudhore të licencuara dëshmi për nivelin dhe shtrirjen e mbulimit të tyre ekzistues për detyrimet në rast aksidentesh, përveç rasteve kur ato kanë kontraktuar një sigurim ose autoriteti tashmë e ka këtë informacion. Ai mund të kërkojë gjithashtu dëshmi të tilla nga sipërmarrjet hekurudhore, në rast se ka dyshime nëse mbulimi i tyre plotëson kërkesat e referuara në nenin 23, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

4. Në rast se sipërmarrja nuk demonstron se është e siguruar në mënyrë të përshtatshme, por se ka garanci për mbulim, autoriteti licencues, nëse është e nevojshme, pas konsultimit me Autoritetin Rregullator Hekurudhor, shqyrton nëse kushtet në të cilat sipërmarrja ka marrë këto garanci korrespondojnë me kushtet e tregut që do të ishin marrë nga çdo sipërmarrje tjetër me të njëjtin nivel të gjendjes financiare dhe ekspozimit ndaj rrezikut.

5. Nëse autoriteti licencues pezullon licencën, në përputhje me nenin 25, pika 2, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", ose jep një licencë të përkohshme në përputhje me nenin 25, pika 3, të ligjit në fjalë, ai duhet të informojë çdo autoritet tjetër kompetent me të cilën ajo e di se sipërmarrja hekurudhore kishte kontraktuar shërbime. Nëse autoriteti licencues ka dyshime në lidhje me përputhshmërinë e garancive për mbulimin e detyrimeve të tij me rregullat e kombëtare për ndihmën shtetërore, ai mund t'u transmetojë informacionin e nevojshëm autoriteteve përgjegjëse për kontrollin e këtyre rregullave të ndihmës shtetërore.

Neni 6
Marrëdhënia me certifikatat e sigurisë

1. Dhënia e licencës nuk mund të kushtëzohet nga sipërmarrja që zotëron një certifikatë sigurie të përmendur në nenin 23, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

2. Nëse një sipërmarrje ka një certifikatë sigurie, autoriteti licencues nuk kontrollon kërkesat për certifikatat e sigurisë, kur jep licencën.

Neni 7
Disa aspekte të procedurës për dhënien e licencës

1. Brenda një muaji nga marrja e aplikimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit, autoriteti licencues informon sipërmarrjen se dosja është e plotë ose kërkon informacion plotësues. Ky afat kohor mund të zgjatet me dy javë në rrethana të jashtëzakonshme dhe sipërmarrja duhet të informohet për këtë. Pasi të jetë marrë informacioni plotësues, autoriteti licencues informon sipërmarrjen brenda maksimumi një muaji nëse dosja është e plotë.

2. Autoriteti licencues kërkon vetëm dokumente të përmendura në kreun II, seksionin e 2-të, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", të përmbledhura në aneksin 3, deklarimet sipas anekseve 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje ose të kërkuara nga legjislacioni kombëtar. Autoriteti licencues publikon një listë të të gjitha dokumenteve dhe përmbajtjes së tyre, dhe nuk kërkon asnjë dokument tjetër nga sipërmarrjet. Nëse lista përditësohet dhe publikohet, sipërmarrjet mund të mbështeten ende në listën e mëparshme, për sa i përket aplikimeve që kanë paraqitur përpara përditësimit.

3. Në lidhje me sipërmarrjet me të ardhura vjetore prej më pak se 5 milionë euro nga aktivitetet e transportit hekurudhor, autoriteti licencues mund të marrë në konsideratë kërkesën në lidhje me aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet aktuale dhe të mundshme, për një periudhë prej 12 muajsh nga fillimi i operacioneve, në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", nëse sipërmarrja mund të demonstrojë se kapitali i saj neto është të paktën 100 000 euro ose një shumë e rënë dakord me Autoritetin Rregullator Hekurudhor. Autoriteti licencues publikon këtë shumë.

Neni 8
Tarifat e licencimit

Tarifat e licencimit për shqyrtimin e çdo aplikimi aplikohen në mënyrë jodiskriminuese.

ANEKS 1
Format standard për dokumentin e licencës

INFORMACION PËR LICENCËN PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT HEKURUDOR

Brenda Bashkimit dhe Zonës Ekonomike Evropiane sipas Direktivës 2012/34/BE dhe legjislacionit kombëtar përkatës.

1. Shteti lëshues i licencës

Shteti lëshues	☐ Licencë e re ☐ Licenca e ndryshuar
Licenca kombëtare Nr	Identifikimi i vendimit
Legjislacioni në fuqi	
Autoriteti licencues	Nr. i telefonit
adresa postale	
Kodi postar dhe qyteti	E-mail

2. Mbajtësi i licencës

Ndërmarrje hekurudhore	Nr. i telefonit
adresa postale	
Kodi postar dhe qyteti	E-mail
Nr Regjistrimi	Nr TVSH

3. Vlefshmëria

Vlefshme nga	Licenca e përkohshme: ☐ PO ☐ NR Nëse po: e vlefshme deri
Lloji i shërbimeve: ☐ vetëm tërheqje ☐ mallrave ☐ pasagjer	
Pezulluar më	Revokuar më

4. Ndryshimet

Ndryshuar më

Përshkrimi i amendamentit

5. Kushtet dhe detyrimet

Kushtet sipas nenit 23(2) të Direktivës 2012/34/BE duhet të përmenden këtu, ose duhet të jepet referencë se ku disponohet dokumentacioni

Data	Nënshkrimi
Emri	
KE-licencë-njoftim Nr	

Shpjegime për plotësimin e shabllonit të licencës

Legjislacioni është përcaktuar në ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" dhe licencat hekurudhore të lëshuara sipas këtij ligji janë të vlefshme edhe në Zonën Ekonomike Evropiane dhe në Bashkimin Evropian.

Çdo herë që merret një vendim që prek dokumentin e licencës së një sipërmarrjeje të caktuar hekurudhore të licencuar, d.m.th. ndryshimi, pezullimi, revokimi ose zëvendësimi i një licence të përhershme me një të përkohshme, një dokument i ri licence duhet t'i komunikohet Agjencisë Evropiane të Hekurudhave.

Dokumenti i licencës shoqërohet gjithmonë me aneksin për mbulimin financiar të detyrimit.

Shpjegimet e mëposhtme i referohen fushave të numëruara të formularit. Referencat i bëhen neneve të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

Shteti lëshues i licencës. Duhet të tregohet gjithmonë nëse një dokument ka të bëjë me një licencë të re ose çdo lloj ndryshimi në një licencë ekzistuese. Legjislacioni i zbatueshëm në shtetin lëshues duhet të identifikohet duke iu referuar ligjit ose dispozitave të tjera ligjore. Numri i identifikimit të licencës i përdorur në shtetin lëshues duhet të futet dhe, sipas rastit, identifikimi i vendimit të autoritetit nëpërmjet një numri referimi ose referencë tjetër përkatëse. Autoriteti licencues caktohet në përputhje me nenin 17. Ai duhet të identifikohet në një mënyrë që të mundësojë që palët e interesuara të kenë kontakt me organin në fjalë. Numrat e telefonit duhet të tregojnë numrin e institucionit, aty ku është e mundur, dhe jo tek personi përgjegjës për çështjet e licencimit. Numrat e telefonit dhe faksit duhet të tregojnë kodin e shtetit.

Adresa e postës elektronike duhet të jetë kutia e përgjithshme postare e autoritetit.

Mbajtësi i licencës. Të dhënat e kontaktit të mbajtësit të licencës duhet, në mënyrë të ngjashme me të dhënat e autoritetit, të tregojnë adresat e përgjithshme të sipërmarrjes hekurudhore, duke shmangur referencën për një person të caktuar.

Nëse mbajtësit i atribuohen disa numra regjistrimi sipas ligjit kombëtar, ka mundësi në formular për të futur numrin e TVSH-së dhe numrin e dytë të regjistrimit. Numrat e telefonit dhe faksit duhet të tregojnë kodin e shtetit.

Vlefshmëria. Sipas fjalisë së parë të nenit 24, pika 2, një licencë është e vlefshme për sa kohë sipërmarrja hekurudhore përmbush detyrimet e ligjit.

Autoriteti lëshues duhet të tregojë datën e parë të vlefshmërisë dhe llojin(et) e shërbimeve për të cilat është e vlefshme licenca.

Në rastin e një licence të përkohshme, të lëshuar sipas dispozitave të nenit 25, pika 3, duhet të shënohet një datë përfundimi.

Vlefshmëria maksimale e një licence të përkohshme është gjashtë muaj. Në rast pezullimi ose revokimi, datat duhet të shënohen në formular. Datat duhet të futen në një format të përbashkët (dd.mm.yy).

Amendamentet. Nëse sipërmarrja hekurudhore e licencuar ndryshon ose zgjeron ndjeshëm aktivitetet e saj, licenca do të riparaqitet për shqyrtim sipas nenit 25, pika 6. Një rishikim i tillë mund të shkaktojë ndryshimin e licencës dhe nëse po, data e ndryshimit do të futet në fushë së bashku me një përshkrim të shkurtër. Datat do të futen në një format të përbashkët (dd.mm.yy).

Kushtet dhe detyrimet. Dispozita të veçanta që rregullojnë pezullimin ose revokimin e një licence mund të përfshihen në vetë licencën. Nëse është kështu, dispozitat duhet të tregohen në këtë fushë.

Nënshkrimi. Një person i autorizuar nga autoriteti licencues për të vendosur për licencat duhet të vërtetojë dhe t'ia komunikojë dokumentin e licencës Agjencisë Evropiane të Hekurudhave. Emri i personit nënshkrues duhet të shkruhet.

ANEKS 2

Format standard për aneksin e përgjegjësisë në licencën hekurudhore

LIÇENSË

Shtojca e përgjegjësisë Nr

Mbulesa financiare për detyrimin

Në lidhje me licencën për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor brenda Bashkimit dhe Zonës Ekonomike Evropiane sipas Direktiva 2012/34/BE dhe legjislacioni kombëtar përkatës

1. Shteti lëshues i licencës

Shteti lëshues	Autoriteti licencues
Licenca kombëtare Nr	Identifikimi i vendimit
Legjislacioni në fuqi	

2. Mbajtësi i licencës

Ndërmarrje hekurudhore	
Nr Regjistrimi	Nr TVSH

3. Autoriteti licencues (nëse është i ndryshëm nga autoriteti licencues në 1)

Autoriteti licencues	Nr. i telefonit
adresa postale	
Kodi postar dhe qyteti	E-mail
Shtetit	Legjislacioni në fuqi

4. Mbulesa financiare për detyrimin

Mbulesa financiare, shuma	Garancitë në kushtet e tregut (përshkrim i shkurtër)
Mbulimi gjeografik	
Vlefshme nga	I vlefshëm deri

5. Kushtet dhe detyrimet

Kushtet kombëtare sipas nenit 22, nenit 23(2) dhe/ose (3) të Direktivës 2012/34/BE duhet të përmenden këtu, ose duhet t'i jepet referencë se ku disponohet dokumentacioni.

Data Nënshkrimi

	Emri
KE-licencë-njoftim Nr	

Shpjegime dhe udhëzime për përdorim

Shteti lëshues i licencës. Informacioni i dhënë në licencë do të përsëritet këtu për të mundësuar identifikimin e saktë të licencës. Autoriteti licencues caktohet nga shtetet anëtare, sipas nenit 17. Meqenëse aneksi është i lidhur me një dokument licence, sipas aneksit I të kësaj rregulloreje, nuk është e nevojshme të përsëriten të gjitha informacionet e dhëna për autoritetin licencues. Emri është i mjaftueshëm.

Mbajtësi i licencës. Meqenëse aneksi është i lidhur me një licencë, nuk është e nevojshme të përsëriten të gjitha informacionet e dhëna për mbajtësin e licencës. Emri dhe numrat e mundshëm të regjistrimit janë të mjaftueshëm.

Organi licencues përgjegjës për vërtetimin e mbulimit financiar. Nëse aneksi i përgjegjësisë dorëzohet nga autoriteti që i jep licencën sipërmarrjes hekurudhore, kjo fushë nuk duhet të plotësohet. Në rast se një autoritet licencues në një shtet tjetër anëtar ka kërkuar dhe miratuar mbulim sigurimi shtesë, detajet përkatëse të kontaktit të atij autoriteti licencues duhet të futet në këtë fushë. Numrat e telefonit dhe faksit duhet të tregojnë kodin e shtetit.

Mbulesa financiare për detyrimin. Shuma e mbulesës që kërkohet dhe miratohet do të shënohet në këtë fushë, duke treguar monedhën në të cilën është shënuar. Nëse sipërmarrja hekurudhore nuk ka lidhur një polic sigurimi, por ka demonstruar mbulimin e saj me garanci adekuate në kushtet e tregut (p.sh. një garanci financiare), do të përshkruhet natyra e këtij mbulimi. Nëse mbulimi gjeografik është i kufizuar në një vend ose në një rajon të caktuar, ose nëse disa vende ose rajone janë të përjashtuara në mënyrë specifike, duhet të përshkruhet. Do të shënohet data e parë e vlefshmërisë së policës së sigurimit. Sipërmarrja hekurudhore ka detyrimin të ruajë mbulimin e përgjegjësisë. Licenca nuk është e vlefshme nëse sipërmarrja hekurudhore nuk e plotëson këtë kërkesë seksioni 2. Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme, një sigurim mund të merret për një kohë të kufizuar. Në një rast të tillë mund të vendoset një datë mbarimi i vlefshmërisë. Datat do të futen në një format të përbashkët (dd.mm.yy). Autoriteti licencues mund të kontrollojë nëse sipërmarrja hekurudhore i përmbush kërkesat sipas nenit 25.

Kushtet dhe detyrimet. Mbulimi i përgjegjësisë mund të lidhet me kushtet kombëtare ose detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrjes hekurudhore nga dispozitat e nenit 23. Në këtë rast, duhet të tregohet në këtë fushë.

Nënshkrimi. Një person i autorizuar nga autoriteti licencues për të miratuar marrëveshjet e sigurimit brenda procedurës së licencimit vërteton dhe ia komunikon dokumentin Agjencisë Evropiane të Hekurudhave. Emri i personit nënshkrues duhet të shkruhet.

Njoftimi i licencës KE-numri.

ANEKS 3

Kërkesat e nevojshme për marrjen e licencës

1	Kërkesa ku tregohet: a) tipi i shërbimeve të kërkuara: □ transporti kombëtar i mallrave; □ transporti kombëtar i udhëtarëve; □ transporti ndërkombëtar i udhëtarëve; □ transporti ndërkombëtar i mallrave, b)Data e parashikuar për fillimin e aktivitetit:	Sipërmarrësi hekurudhor
2	Reputacioni i mirë i subjektit: - Nuk kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale, përfshirë ato të një natyre tregtare; - Nuk kanë shpallur falimentin; -Nuk kanë qenë të dënuar për kundërvajtje të rënda, të parashikuara në legjislacionin në fuqi; - Nuk kanë qenë të dënuar më parë për mospërmbushje të detyrimeve tatimore, doganore, mosshlyerjen e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.	Sipërmarrësit hekurudhor dhe përfaqësuesit e tyre
3	Gjendja e përshtatshme financiare: - Vërtetim mbi vlerësimin e gjendjes financiare (bilanci vjetor, fondet që disponon, përfshirë dispozitat bankare, kapacitetin huamarrës, kreditë; asetet duke përfshirë dhe pronat, të cilat personi juridik mund t'i lerë peng si garanci, kapitalin në përdorim, kostot e blerjeve dhe paradhëniet për automjetet, tokën, ndërtesat, instalimet dhe mjetet hekurudhore, detyrimet që rëndojnë mbi asetet e ndërmarrjes; - Vërtetim që subjekti nuk ka detyrime të prapambetura ndaj administratës tatimore dhe se ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore, të cilat kanë rezultuar nga aktiviteti i mëparshëm; - Planbiznesi i aktivitetit të subjektit për vitin kur kërkohet licenca, si dhe për dy vitet pasuese, ku të ndahet aktiviteti i transportit hekurudhor nga aktivitetet e tjera. Veçanërisht të paraqiten: a) përshkrimi sasior dhe cilësor i produkteve dhe shërbimeve që ofrohen; b) një organigramë e organizimit të subjektit, e personelit në shërbim, si dhe kualifikimet e tyre; c) kostot e parashikuara për operim, të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti i transportit hekurudhor, të ndara nga aktivitetet e tjera. Nëse këto nuk mund të ndahen, të paraqiten të dhënat vijuese: - Shuma vjetore e parashikuar për tarifën e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore. në sektorin e transportit". - Kjo garanci pasurore, që përfshin kapitalin e vlefshëm ose	Sipërmarrësi hekurudhor: - shoqëron kërkesën me vlerësimin e gjendjes financiare sipas kërkesave të parashtruara; - plotëson këtë vërtetim; - përgatit planbiznesin. Subjekti përgatit këto të dhëna për tri vitet e para të ushtrimit të aktivitetit.
	rezerva financiare, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32/2021, datë 16.3.2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Vlerësimi i kostos mesatare për trenkilometër, duke specifikuar shpenzimet e mirëmbajtjes. - Investimet e parashikuara dhe financimi i tyre. - Paraqitja e dokumentit që subjekti merr përsipër të mbulojë përgjegjësinë e tij civile në rast aksidenti, sidomos lidhur me udhëtarët, bagazhet, mallrat, të tretët dhe administruesin e infrastrukturës hekurudhore.	Subjekti plotëson formularin e vetëdeklarimit, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje
4	Dokumentacioni i kompetencës profesionale: a) Material ku të përshkruhet se subjekti ka ose do të ketë organizimin e duhur, njohjen dhe/ose eksperiencën e nevojshme për të realizuar operacionet e transportit hekurudhor dhe një mbikëqyrje të sigurt të tipit të operacionit të specifikuar në lejen e veprimtarisë; b) Personeli përgjegjës i lëvizjes dhe sigurisë së trenave ka kualifikimin e duhur në fushat e tyre të aktivitetit, në përputhje me ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.	Subjekti juridik paraqet materialin. Subjekti juridik paraqet dokumentacionin justifikues të aftësisë profesionale (dëshmitë e aftësisë dhe dokumente të tjera)

5	Dokumentacioni për disponimin e mjeteve lëvizëse, si dhe gjendja e tyre teknike: a) Numri dhe tipi i lokomotivave në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast); b) Numri dhe tipi i vagonëve të udhëtarëve në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast); c) Numri dhe tipi i vagonëve të mallrave në pronësi ose të marra me qira (paraqitja e dokumentacionit përkatës për çdo rast); d) Gjendja e mirë teknike e mjeteve lëvizëse, në përputhje me plotësimin e rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare (vërtetim i lëshuar nga ASH-ja); e) Regjistrimi i tyre në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve (vërtetim i lëshuar nga ASH-ja).	Ky dokumentacion paraqitet nga subjekti që kërkon lejen e veprimtarisë
6	Ekstrakt historik dhe të thjeshtë të subjektit me nënshkrim elektronik	
7	- Fotokopje të noterizuar të vendimit të emërimit e të paktën një personi të caktuar për të drejtuar efektivisht dhe vazhdimisht aktivitetin e transportit hekurudhor (drejtues teknik). - Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë. - Dokument për eksperiencën e punës mbi 5 vjet në fushën e transportit hekurudhor (dokumenti lëshohet nga HSH-ja). -CV-ja e drejtuesit teknik. - Çdo dokument tjetër të kërkuar nga autoriteti që lëshon licencat.	Ky dokumentacion përgatitet nga subjekti

ANEKS 4

Formular vetëdeklarimi për përgjegjësinë civile

FORMULARI I VETËDEKLARIMIT
PËR SUBJEKTIN QË KËRKON LICENCË, LIDHUR ME MBULIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE NË RAST AKSIDENTI, SIDOMOS LIDHUR ME UDHËTARËT, BAGAZHET, MALLRAT, POSTËN, TË TRETËT DHE ADMINISTRUESIN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Unë i nënshkruari _____, administrator i veprimtarisë së shoqërisë _____, me seli në _____, deklaroj se jam banues në adresën _____, tel fiks: _____, cel: _____ dhe me dokument identifikimi nr. i letër njoftimit/pasaportës _____.

Deklaroj se shoqëria _____, e regjistruar në QKB me NUIS/NIPT me nr. _____, datë_____, ndryshuar me nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie për _____ të cilin kërkoj të më jepet licenca:

do të mbuloj të gjitha përgjegjësitë civile në rast aksidenti, sidomos lidhur me udhëtarët, bagazhet, mallrat, postën, të tretët dhe administruesin e infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32/2021, datë 16.3.2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

DEKLARUESI

_____

(Vetëdeklarim i nënshkruar nga drejtuesi i veprimtarisë së transportit)

(*emër, mbiemër, firmë, vulë*)

Datë: / /

Shënim. Ky aneks lëshohet në bazë të nenin 21, pika 5, e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

ANEKS 5

Formular vetëdeklarimi për subjektin

Unë i nënshkruari _____, administrator i veprimtarisë së shoqërisë _____, me seli në _____, deklaroj se jam banues në adresën _____, tel. fiks: _____, cel: _____ dhe me dokument identifikimi nr. i letër njoftimit/pasaportës _____.

Deklaroj se shoqëria _____, e regjistruar në QKB me NUIS/NIPT me nr. _____, datë _____, ndryshuar me nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie për _____ të cilin kërkoj të më jepet licenca, nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj të tretëve (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve, doganave, organeve të pushtetit vendor).

Deklaroj që nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor, nuk jam shpallur fajtor në Shqipëri apo në vende të tjera për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë shkelje të ligjit të punës, mbrojtjes në punë, legjislacionit specifik të zbatueshëm në transportin hekurudhor.

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Kërkoj të pajisem me leje veprimtarie për aktivitetin e transportit hekurudhor:

☐ kombëtar të udhëtarëve;
☐ ndërkombëtar të udhëtarëve;
☐ kombëtar të mallrave;
☐ ndërkombëtar të mallrave,

- në të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar □
- në linjën hekurudhore □

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se: "Të gjitha deklarimet e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

DEKLARUESI

_____

(Vetëdeklarim i nënshkruar nga drejtuesi i veprimtarisë së transportit)
(*emër, mbiemër, firmë, vulë*)

ANEKS 6

Formular vetëdeklarimi për drejtuesin e veprimtarisë

Datë

FORMULARI I VETËDEKLARIMIT PËR DREJTUESIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT
(*drejtuar autoritetit kompetent ku bëhet aplikimi*)

Unë i nënshkruari _____ deklaroj që jam banues në adresë: _____, tel. cel.: _____ dhe me dokument identifikimi/nr. pasaporte _____.

Deklaroj që jam drejtues veprimtarie i shoqërisë së transportit _____ me seli në _____, me objekt veprimtarie _____, e cila kërkon të licencohet.

Deklaroj që jam i punësuar si drejtues veprimtarie në shoqëritë:

-
-

Deklaroj që nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor, nuk jam shpallur fajtor për shkelje të ligjit të punës, legjislacionit të transportit dhe në veçanti për shkelje të rregullave, lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit.

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se: "Të gjitha deklarimet e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

DEKLARUESI

_____

(Vetëdeklarim i nënshkruar nga drejtuesi i veprimtarisë së transportit)
(*emër, mbiemër, firmë, vulë*)

URDHËR
Nr. 169, datë 13.12.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË VETME TË SIGURISË PËR SIPËRMARRJET HEKURUDHORE"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 60, pika 2 dhe pika 4, shkronja "b" dhe nenit 65, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe sipërmarrjet hekurudhore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË VETME TË SIGURISË PËR SIPËRMARRJET HEKURUDHORE[2]

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave praktike që duhen zbatuar nga sipërmarrjet hekurudhore kur dorëzojnë aplikime dhe nga organet e certifikimit të sigurisë kur vlerësojnë aplikimet, për certifikata të vetme sigurie, për rinovimin ose përditësimin e këtyre certifikatave, si dhe koordinimin e Autoritetit Kombëtar të Sigurisë, më poshtë Autoriteti me Agjencinë Evropiane të Hekurudhave, më poshtë Agjencia.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Organ certifikimi i sigurisë" nënkupton organin përgjegjës për lëshimin e një certifikate të vetme sigurie, Autoriteti ose Agjencia;

2. "Data e marrjes së aplikimit" do të thotë:

a) dita e parë e punës e Autoritetit, kur vepron ai si organ certifikimi i sigurisë; ose

b) kur Agjencia vepron si organi i certifikimit të sigurisë, ditën e parë të punës së përbashkët për Agjencinë dhe për Autoritetin, pas konfirmimit të marrjes së dosjes së aplikimit;

3. "Para-angazhim" është një fazë procedurale që i paraprin dorëzimit të një aplikimi, gjatë së cilës aplikanti mund të kërkojë informacion shtesë mbi fazat vijuese të procesit të vlerësimit të sigurisë nga organi i certifikimit të sigurisë;

4. "Shqetësim i mbetur" do të thotë një çështje e identifikuar gjatë vlerësimit të një aplikimi për një certifikatë të vetme sigurie, e cila nuk pengon lëshimin e saj dhe mund të shtyhet për mbikëqyrje të mëvonshme.

Neni 3
Përgjegjësitë e organit të certifikimit të sigurisë

1. Përveç lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë, organi i certifikimit të sigurisë është përgjegjës për këto detyra:

a) planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e punës së vlerësimit që kryen;

b) vendosjen e marrëveshjeve të koordinimit ndërmjet palëve përkatëse.

2. Organi i certifikimit të sigurisë pranon para-angazhimin me kërkesë të aplikantit dhe japin çdo sqarim të kërkuar nga aplikanti në kontekstin e para-angazhimit.

3. Për qëllimet e lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë, organi i certifikimit të sigurisë përpilon informacionin e mëposhtëm:

a) të gjithë informacionin përkatës në lidhje me fazat e ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë arsyet

[2] *Kjo rregullore përafron plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) 2018/763, e datës 9 prill 2018, "Vendosja e rregullave praktike për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizimi i Rregullores së Komisionit (EC) nr. 653/2007", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 32018R0763, seria L 129/49, datë 25.5.2018.*

për vendimet e marra gjatë vlerësimit dhe identifikimin e çdo kufizimi ose kushti përdorimi që do të përfshihet në certifikatën e vetme të sigurisë;

b) rezultatin e vlerësimit, duke përfshirë konkluzionet përmbledhëse dhe aty ku është e përshtatshme, një opinion në lidhje me lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë.

4. Organi i certifikimit të sigurisë publikon dhe mban të përditësuar një udhëzues aplikimi, pa pagesë, duke përshkruar dhe kur është e nevojshme duke shpjeguar kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe rregullat procedurale kombëtare.

5. Agjencia monitoron datat e skadencës së të gjitha certifikatave të vetme të vlefshme të sigurisë me një zonë operimi në më shumë se një shtet dhe ndan atë informacion me autoritetet përkatëse kombëtare të sigurisë.

6. Autoriteti ndan me Agjencinë dhe autoritetet e tjera kombëtare të sigurisë, që lidhen me zonën e synuar të operimit, të gjithë informacionin përkatës që mund të ketë ndikim në procesin e vlerësimit të sigurisë.

7. Autoriteti, në zbatim të nenit 65, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", vendos rregullime ose procedura të brendshme për administrimin e procesit të vlerësimit të sigurisë dhe njofton Agjencinë.

8. Çdo certifikate të vetme sigurie i vendoset një numër unik Identifikimi Evropian (EIN) sipas përcaktimit të bërë nga Agjencia dhe janë të disponueshme në faqen e saj të internetit.

9. Në rastet e operimit në stacione afër kufirit me shtetet fqinje, me karakteristika të ngjashme rrjeti dhe rregullash hekurudhore, certifikata e vetme e sigurisë është e vlefshme pa kërkuar një zgjerim të zonës së operimit me kusht që, autoritetet kombëtare të sigurisë të shteteve përkatëse, janë konsultuar më parë dhe kanë konfirmuar se rregullat kombëtare dhe detyrimet në lidhje me marrëveshjet përkatëse ndërkufitare janë përmbushur, përpara lëshimit të certifikatës së vetme të sigurisë.

10. Organi i certifikimit të sigurisë, për qëllime të vlerësimit të aplikimeve, pranon autorizimet, njohjet ose certifikatat e produkteve, ose shërbimeve të ofruara nga sipërmarrjet hekurudhore ose kontraktorët, partnerët ose furnizuesit e tyre, të dhëna si provë të aftësisë së sipërmarrjeve hekurudhore për të përmbushur kërkesat përkatëse të sigurisë.

Neni 4
Përgjegjësitë e aplikantëve

1. Pa cenuar afatin kohor të lejuar për vlerësimin e përcaktuar në nenin 6, aplikanti duhet të paraqesë kërkesën për një certifikatë të vetme sigurie, për përditësimin ose rinovimin e saj, sipas rastit:

4.6.2 Transporti i pasagjerëve me përjashtim të shërbimeve me shpejtësi të lartë
4.6.3 Transport mallrash duke përfshirë shërbimet e mallrave të rrezikshme
4.6.4 Transport mallrash me përjashtim të shërbimeve të mallrave të rrezikshme
4.6.5 Vetëm devijimi
4.6.6 Operacione të tjera
5. Legjislacioni kombëtar i zbatueshëm
6. Zona e veprimit
7. Kufizimet dhe kushtet e përdorimit
8. Informacion shtesë
9. Data e lëshimit dhe nënshkruesi/vula e autorizuar e autoritetit

URDHËR
Nr. 170, datë 13.12.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT SIGURIE PËR MONITORIMIN QË ZBATOHET NGA SIPËRMARRJET HEKURUDHORE, ADMINISTRATORËT E INFRASTRUKTURËS DHE NGA SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR MIRËMBAJTJEN, PAS MARRJES SË CERTIFIKATËS SË VETME TË SIGURISË OSE AUTORIZIMIT TË SIGURISË"

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2 dhe shkronjës "c", të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
MBI NJË METODË TË PËRBASHKËT SIGURIE, PËR MONITORIMIN QË ZBATOHET NGA SIPËRMARRJET HEKURUDHORE, ADMINISTRATORËT E INFRASTRUKTURËS DHE NGA SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR MIRËMBAJTJEN, PAS MARRJES SË CERTIFIKATËS SË VETME TË SIGURISË OSE AUTORIZIMIT TË SIGURISË[3]

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është vendosja e një metode të përbashkët sigurie për monitorimin, duke mundësuar menaxhimin efektiv të sigurisë në sistemin hekurudhor gjatë aktiviteteve të funksionimit dhe mirëmbajtjes së tij dhe, sipas rastit, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rritja e sigurisë në transportin hekurudhor dhe përmirësimi i mirëmbajtjes nëpërmjet:

a) kontrollit për zbatimin e saktë dhe efektivitetin e të gjitha proceseve dhe procedurave në sistemin e menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut. Në rastin e sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës, kontrolli përfshin elementet teknike, operacionale dhe organizative që janë të nevojshme për lëshimin e certifikimit/autorizimit të specifikuar në nenet 65 dhe 66, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";

b) kontrollin për zbatimin e saktë të sistemit të menaxhimit në tërësi, dhe nëse sistemi i menaxhimit arrin rezultatet e pritura; dhe

c) identifikimin dhe zbatimin e masave të duhura parandaluese, korrigjuese ose të dyja llojet e masave nëse zbulohet ndonjë rast përkatës i mospërputhjes me pikat "a" dhe "b".

[3] *Kjo rregullore përafron plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1078/2012, e datës 16 nëntor 2012 "Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që do të zbatohet nga ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës pas marrjes së një certifikate sigurie ose autorizimi sigurie dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 32012R1078, seria L 320/8, datë 17.11.2012.*

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet në transportin hekurudhor shqiptar për sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas marrjes së certifikatës së sigurisë ose autorizimit të sigurisë.

Neni 4
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e nenit 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë". Përveç tyre, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "sistemi i menaxhimit të sigurisë" nënkupton ose janë sistemet e menaxhimit të sigurisë të sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës, për të siguruar menaxhimin e sigurt të operacioneve të saj dhe që është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 64, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", ose sistemi i mirëmbajtjes së subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 137 të këtij ligji;

b) "monitorim" nënkupton marrëveshjet e vendosura nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës ose subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen për të kontrolluar zbatimin e saktë dhe efektiv të sistemit të tyre të menaxhimit;

c) "ndërveprim" nënkupton të gjitha pikat e ndërveprimit gjatë kohës së funksionimit të një sistemi ose nënsistemi, duke përfshirë funksionimin dhe mirëmbajtjen ku aktorë të ndryshëm të sektorit hekurudhor punojnë së bashku për të menaxhuar rreziqet.

Neni 5
Procesi i monitorimit

1. Çdo sipërmarrje hekurudhore, administrator infrastrukture dhe subjekt përgjegjës për mirëmbajtjen është përgjegjës për kryerjen e procesit të monitorimit, sipas përcaktimeve në aneksin bashkëlidhur.

Ky proces siguron që masat e kontrollit të rrezikut, të zbatuara nga kontraktorët e tyre, të monitorohen gjithashtu në përputhje me këtë rregullore. Për këtë qëllim, ata zbatojnë procesin e monitorimit të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur, ose do të kërkojnë nga kontraktorët e tyre që ta zbatojnë këtë proces nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale.

2. Procesi i monitorimit përmban aktivitetet e mëposhtme:

a) përcaktimin e strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) për monitorim;

b) mbledhjen dhe analizën e informacionit;

c) hartimin e një plani veprimi për rastet e mospërputhjes së papranueshme me kërkesat e përcaktuara në sistemin e menaxhimit;

ç) zbatimin e planit të veprimit, nëse hartohet një plan i tillë;

d) vlerësimin e efektivitetit të masave të planit të veprimit, nëse hartohet një plan i tillë.

Neni 6
Shkëmbimi i informacionit ndërmjet aktorëve të përfshirë

1. Sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, duke përfshirë kontraktorët e tyre, duhet të sigurojnë, nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale, që çdo informacion përkatës, lidhur me sigurinë që rezulton nga zbatimi i procesit të monitorimit të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur, të shkëmbehet ndërmjet tyre, për të mundësuar palën tjetër të ndërmarrë çdo veprim korrigjues, të nevojshëm për të siguruar arritjen e vazhdueshme të performancës së sigurisë së sistemit hekurudhor.

2. Nëse, nëpërmjet aplikimit të procesit të monitorimit, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen identifikojnë çdo rrezik të rëndësishëm sigurie, në lidhje me defektet dhe mospërputhjet e ndërtimit ose keqfunksionimet e pajisjeve teknike, përfshirë ato të nënsistemeve strukturore, ata ia raportojnë këto rreziqe palëve të tjera të përfshira, për t'iu mundësuar atyre të ndërmarrin veprimet e nevojshme korrigjuese, për të siguruar arritjen e vazhdueshme të performancës së sigurisë së sistemit hekurudhor.

Neni 7
Raportimi

1. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës i raportojnë Autoritetit Kombëtar të Sigurisë, në vijim Autoriteti, për zbatimin e kësaj rregulloreje, nëpërmjet raporteve të tyre vjetore të sigurisë, në përputhje me nenin 64, pika 7, ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

2. Autoriteti raporton te Agjencia Evropiane e Hekurudhave, në vijim Agjencia, për zbatimin e kësaj rregulloreje nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe për aq sa ka dijeni, nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen në përputhje me nenin 72 të ligjit më sipër.

3. Raporti vjetor i mirëmbajtjes së subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave i cili, vihet gjithashtu në dispozicion me kërkesë të Autoritetit, përfshin të gjitha informacionet/të dhënat përkatëse të nevojshme dhe informacion për përvojën e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtje në zbatimin e kësaj rregulloreje. Agjencia e mbledh këtë informacion në koordinim me organet përkatëse të certifikimit.

4. Subjektet e tjera përgjegjëse për mirëmbajtjen, që nuk përfshihen në detyrimin e pajisjes me certifikatë për mirëmbajtjen, ndajnë gjithashtu përvojën e tyre me Agjencinë për zbatimin e kësaj rregulloreje. Agjencia koordinon shkëmbimin e përvojës me këto subjekte përgjegjëse për mirëmbajtjen.

5. Autoriteti mbështet Agjencinë në mbledhjen e këtij informacioni nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës.

ANEKS

Procesi i monitorimit

1. Të përgjithshme

1.1 Dokumentet në procesin e monitorimit do të jenë të gjitha proceset dhe procedurat e përfshira në sistemin e menaxhimit, duke përfshirë masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut.

1.2 Aktivitetet e përmendura në nenin 5, pika 2 e rregullores së procesit të monitorimit përshkruhen në seksionet 2 deri në 6.

1.3 Ky proces monitorimi përsëritet vazhdimisht, siç tregohet në diagramin më poshtë në shtojcë.

2. Përcaktimi i strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) për monitorim

2.1 Bazuar në sistemin e tyre të menaxhimit, çdo sipërmarrje hekurudhore, administrator infrastrukture dhe ent përgjegjës për mirëmbajtjen është përgjegjës për përcaktimin e strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) të monitorimit.

2.2 Vendimi për atë që duhet dhënë përparësi do të marrë parasysh informacionin nga fushat që sjellin rreziqet më të mëdha dhe, nëse nuk monitorohen në mënyrë efektive, mund të çojnë në pasoja negative për sigurinë. Vendoset një renditje prioriteti për aktivitetet e monitorimit dhe tregohet koha, mundi dhe burimet e nevojshme. Përcaktimi i prioriteteve merr parasysh edhe rezultatet nga aplikimet e mëparshme të procesit të monitorimit.

2.3 Procesi i monitorimit identifikon, sa më herët që të jetë e mundur, raste të mospërputhjes në aplikimin e sistemit të menaxhimit që mund të rezultojë në aksidente, incidente, për pak humbje ose dukuri të tjera të rrezikshme. Ajo çon në zbatimin e masave për të korrigjuar rastet e tilla të mospërputhjes.

2.4 Strategjia dhe plani(et) e monitorimit përcaktojnë ose tregues sasiorë ose cilësorë, ose një përzierje të të dyjave që mund të:

a) japin paralajmërime të hershme për çdo devijim nga rezultati i pritur, ose siguri se rezultati i pritshëm është arritur siç është planifikuar;

b) japin informacion për rezultatet e padëshiruara;

c) mbështesin vendimmarrjen.

3. Mbledhja dhe analiza e informacionit

3.1 Mbledhja dhe analiza e informacionit kryhet sipas strategjisë, prioriteteve dhe planit(eve) të përcaktuara për monitorimin.

3.2 Për çdo tregues të përcaktuar të përmendur në pikën 2.4, duhet të kryhen sa më poshtë:

a) një koleksion informacioni të nevojshëm;

b) një vlerësim nëse proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut janë zbatuar në mënyrë korrekte;

c) një kontroll nëse proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut janë efektive dhe nëse ato arrijnë rezultatet e pritura;

ç) një vlerësim nëse sistemi i menaxhimit në tërësi zbatohet saktë dhe nëse ai arrin rezultatet e pritura;

d) një analizë dhe vlerësim të rasteve të mospërputhjes së identifikuar me pikat "b", "c" dhe "ç", si dhe identifikimin e shkaqeve të tyre.

4. Hartimi i një plani veprimi

4.1 Për rastet e identifikuara të mospërputhjes, që konsiderohen të papranueshme, hartohet një plan veprimi. Kjo do të:

a) çojë në zbatimin e proceseve, procedurave, masave teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut, të zbatuara në mënyrë korrekte siç specifikohet; ose

b) përmirësojë proceset, procedurat, masat teknike, operacionale dhe organizative të kontrollit të rrezikut ekzistues; ose

c) identifikojnë dhe zbatojnë masa shtesë të kontrollit të rrezikut.

4.2 Plani i veprimit duhet të përfshijë në veçanti informacionin e mëposhtëm:

a) objektivat dhe rezultatet e pritura;

b) korrigjuese, parandaluese ose të dyja llojet e masave të nevojshme;

c) personi përgjegjës për zbatimin e veprimeve;

ç) datat deri në të cilat veprimet do të zbatohen;

d) personi përgjegjës për vlerësimin e efektivitetit të masave të planit të veprimit, në përputhje me nenin 6;

dh) një rishikim i ndikimit të planit të veprimit në strategjinë e monitorimit, prioritetet dhe planin(et).

4.3 Për menaxhimin e sigurisë në ndërveprimet, sipërmarrja hekurudhore, administratori i infrastrukturës ose subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen vendosë, në marrëveshje me aktorët e tjerë të përfshirë, se kush do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit të kërkuar ose pjesëve të tij.

5. Zbatimi i planit të veprimit

5.1 Plani i veprimit, i përcaktuar në seksionin 4, zbatohet në mënyrë që të korrigjohen rastet e identifikuara të mospërputhjes.

6. Vlerësimi i efektivitetit të masave të planit të veprimit

6.1 Zbatimi korrekt, përshtatshmëria dhe efektiviteti i masave të identifikuara në planin e veprimit do të kontrollohen duke përdorur të njëjtin proces monitorimi, siç përshkruhet në këtë shtojcë.

6.2 Vlerësimi i efektivitetit të planit të veprimit përfshin në veçanti veprimet e mëposhtme:

a) verifikimi nëse plani i veprimit është zbatuar dhe plotësuar në mënyrë korrekte sipas planit;

b) verifikimi nëse është arritur rezultati i pritur;

c) verifikimin nëse ndërkohë kanë ndryshuar kushtet fillestare dhe nëse masat e kontrollit të rrezikut, të përcaktuara në planin e veprimit, janë ende të përshtatshme për rrethanat e dhëna;

ç) verifikimi nëse masa të tjera të kontrollit të rrezikut janë të nevojshme.

7. Dëshmi nga aplikimi i procesit të monitorimit

7.1 Procesi i monitorimit dokumentohet për të vërtetuar se është zbatuar saktë. Ky dokumentacion vihet në dispozicion kryesisht për qëllime të vlerësimit të brendshëm. Sipas kërkesës:

a) sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të autoritetit;

b) subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të organit certifikues. Nëse ndërveprimet menaxhohen nëpërmjet kontratave, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen e vënë këtë dokumentacion në dispozicion të sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës.

7.2 Dokumentacioni i prodhuar, sipas pikës 7.1, përfshin në veçanti:

a) një përshkrim të organizatës dhe personelit të caktuar për të kryer procesin e monitorimit;

b) rezultatet e aktiviteteve të ndryshme të procesit të monitorimit, të listuara në nenin 3(2) dhe në veçanti vendimet e marra;

c) në rastin e rasteve të mospërputhshmërisë së identifikuar, që konsiderohen të papranueshme, një listë e të gjitha masave të nevojshme që duhen zbatuar për të arritur rezultatin e kërkuar.

SHTOJCA
Kuadri për procesin e monitorimit



VENDIM
Nr. 63, datë 20.11.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj, kryetare;
Fiona Papajorgji, anëtare;
Elsa Toska, anëtare;
Sonila Bejtja, anëtare;
Sandër Beci, anëtar;
Ilir Toska, anëtar;
Genti Ibrahimi, anëtar;
Marjana Semini, anëtare;
Marsida Xhaferllari, anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.11.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (M) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Maringlen Gjuraj, përfaqësuar nga avokatët Blerim Bazhdari dhe Jordan Daci, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 786 (3491), datë 28.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 113, datë 15.2.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe/ose kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, shkronja "d", 42, pika 2, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "i", të Kushtetutës *(Kushtetuta)*; nenet 3, shkronja "d" dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Maringlen Gjuraj, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 5.7.2015, një grup punonjësish të Policisë së Shtetit dhe forcave speciale kanë zhvilluar një operacion për arrestimin e një të dyshuari për vrasjen e dy shtetasve të huaj. Pas informacionit se i dyshuari kishte kapërcyer murin rrethues të shtëpisë së kërkuesit Maringlen Gjuraj, në Shkodër, kanë hyrë me forcë në banesën e këtij të fundit. Ata kanë ushtruar dhunë për të neutralizuar kërkuesin (i cili ishte personi i vetëm në oborrin e shtëpisë), me argumentin se ka bërë rezistencë dhe nuk ka pranuar të hapë portën e banesës.

2. Punonjësit e policisë nuk e kanë gjetur personin e kërkuar në banesën e kërkuesit, por gjatë kontrollit të ushtruar, në një objekt njëkatësh të ndodhur në oborrin prapa banesës, që shërbente për nevoja pune të familjes, kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale një thikë, një armë zjarri luftarake, automatik model 56 dhe kalibër 7.62 mm, dy krehra me fishekë, një krehër pa fishekë, një armë gjuetie çifte dhe 15 fishekë, si dhe 99 qese plastike me lëndë të dyshuar si psikotrope në masën 17 kg e 306 gr. Në këto rrethana, policia ka arrestuar në flagrancë kërkuesin dhe ka njoftuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 1135 të vitit 2015. Pas arrestimit, kërkuesi është lënë 7 ditë pa ndihmë mjekësore dhe pa mundësi kontakti me familjarët.

3. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokuroria e ka dërguar çështjen në gjyq, duke e akuzuar kërkuesin për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", të parashikuara nga nenet 278, paragrafi i tretë, 279, paragrafi i parë dhe 280 të Kodit Penal (*KP*). Përgjatë gjithë procedimit, kërkuesi ka mbajtur qëndrim mohues ndaj akuzave, duke pretenduar se provat materiale të gjetura janë sajuar nga Policia e Shtetit për të justifikuar dhunën verbale, fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj tij.

4. Disa ditë pas arrestimit të kërkuesit, më 11.7.2015, prindërit e tij janë ankuar për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Policisë së Shtetit tek Avokati i Popullit. Ky i fundit, pas shqyrtimit administrativ të rastit, ka konkluduar se pretendimet për keqtrajtim fizik të kërkuesit ishin të drejta dhe me shkresën e datës 24.7.2015, i ka rekomanduar, ndër të tjera, drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësve të policisë për veprën penale "Tortura në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të KP-së. Po kështu, në datën 15.7.2015, prindërit e kërkuesit kanë paraqitur kallëzim penal pranë asaj prokurorie, të cilit i kanë bashkëlidhur edhe materialin e dërguar nga Avokati i Popullit për trajtimin e rastit në fjalë.

5. Me vendimin e datës 14.9.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja "ç" dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e hetimeve, me arsyetimin se veprimet e kryera ndaj kërkuesit, edhe pse i kanë shkaktuar lëndime të lehta shëndetësore, kanë qenë proporcionale dhe në përputhje me ligjin, ndaj fakti nuk përbënte vepër penale. Në datën 15.12.2015, Avokati i Popullit i ka paraqitur rekomandim kundër këtij vendimi Prokurorit të Përgjithshëm dhe ky i fundit, në datën 23.2.2016, ka vendosur shfuqizimin e tij. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. 359, datë 2.3.2016, për veprën penale "Tortura në bashkëpunim", të parashikuar nga nenet 86 dhe 25 të KP-së. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, prokurori i çështjes, me vendimin e datës 11.2.2020, ka vendosur veçimin e çështjeve dhe ka dërguar në gjyq vetëm çështjen në ngarkim të një prej të pandehurve, me funksion oficer policie dhe me detyrë zëvendësdrejtor, të akuzuar për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", të parashikuar nga neni 250 i KP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1185 (2334), datë 20.4.2021, ka vendosur deklarimin fajtor të zyrtarit të policisë sipas akuzës dhe dënimin e tij me dy vjet burgim. Kundër vendimit është ushtruar ankim dhe prej datës 2.6.2021, çështja është në pritje për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit.

6. Ndërkohë, për sa i takon procedimit penal të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 786 (3491), datë 28.7.2016, ka vendosur deklarimin fajtor të tij për veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit; mbajtjes pa leje të armëve të ftohta; mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë, si dhe dënimin e tij përfundimisht me dy vjet e katër muaj burgim, me arsyetimin se provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai i kishte konsumuar veprat penale për të cilat ishte akuzuar. Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, gjykata ka mbajtur në konsideratë, ndër të tjera, qëndrimin mohues të kërkuesit ndaj akuzave, gjendjen e pastër gjyqësore të tij, moshën 23 vjeç dhe nivelin e lartë arsimor. Kundër vendimit kanë paraqitur apel prokurori për rritjen e masës së dënimit, si dhe kërkuesi për deklarimin e tij të pafajshëm.

7. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 113, datë 15.2.2017, ka vendosur lënien pjesërisht në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rritjen me një muaj të masës së dënimit për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta (nga tre muaj në katër muaj burgim) dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë, për shkak të amnistisë së dhënë me ligjin nr. 141/2016, duke e dënuar kërkuesin me të njëjtën masë dënimi përfundimtare prej dy vjetësh e katër muaj burgim. Gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkuesi e kishte vuajtur dënimin dy vjet e katër muaj, të caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ishte kthyer në gjirin e familjes së tij, ndaj caktimi i një dënimi më të rëndë nuk do të kishte ndikim në riedukimin e tij dhe as efekte parandaluese. Ajo gjykatë ka arsyetuar, ndër të tjera, se lidhur me pretendimin për dhunë fizike të ushtruar nga punonjësit e policisë ndaj kërkuesit në datën 5.7.2015, kishte filluar procedimi penal dhe çështja ishte në hetim nga prokuroria. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi, i cili është regjistruar në datën 18.5.2017.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

9. Në datën 22.3.2023, kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 23.3.2023. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 8577/2000, në datën 31.5.2023 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e

datës 14.6.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

10. Kërkuesi, në parashtrimet shtesë të paraqitura nëpërmjet avokatit të tij në datën 14.7.2023, ka kërkuar thirrjen në gjykim, me cilësinë *amicus curiae,* të Avokatit të Popullit, me argumentin se ky institucion ka hetuar dhe ka arritur në përfundime me rëndësi për pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 18.9.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, por për të realizuar një gjykim kushtetues të plotë dhe të drejtë i ka kërkuar Avokatit të Popullit vënien në dispozicion të të gjitha akteve të hartuar prej tij gjatë hetimit administrativ të rastit të dhunës ndaj kërkuesit. Aktet e paraqitura nga Avokati i Popullit (procesverbale, rekomandime, korrespondenca shkresore dhe akte të tjera) i janë komunikuar për njohje kërkuesit dhe subjektit të interesuar.

12. Me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", Gjykata e Apelit Shkodër ka ndërprerë veprimtarinë në datën 31.1.2023 dhe funksionet e saj ushtrohen nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë. Ndërsa me vendimin nr. 136, datë 28.3.2023, të KLGJ-së "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër", kjo gjykatë prej datës 1.5.2023, ka zëvendësuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këto rrethana, në tekstin e këtij vendimi këto institucione janë referuar me emrat përkatës gjatë kohës së dhënies së vendimeve gjyqësore të tyre.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

13.1.1. *Parimi i gjykatës së pavarur, të paanshme dhe të caktuar me ligj*, pasi gjykatat nuk kanë disponuar në përputhje me ligjin dhe nuk kanë dhënë drejtësi. Në Gjykatën e Lartë nuk janë zbatuar rregullat ligjore të shortit, caktimit të datës së seancës në dhomën e këshillimit, njoftimit për kohën e seancës me afishim në ambientet fizike dhe faqen zyrtare.

13.1.2. *E drejta për t'u njoftuar, dëgjuar dhe mbrojtur,* pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për shqyrtimin e rekursit kërkuesin, as personalisht, as nëpërmjet avokatit, edhe pse ky i fundit kishte shënuar në rekurs numrin e telefonit. Njoftimi me shpallje i individit të izoluar për vuajtjen e dënimit me burgim është i kufizuar dhe nuk e realizon qëllimin e tij. Për rrjedhojë, neni 436, pika 2, i KPP-së, që parashikon njoftimin me shpallje, duhet të shfuqizohet nga Gjykata, pasi cenon procesin e rregullt ligjor për individët e izoluar me burgim. Kërkuesi nuk ka marrë pjesë në gjykim personalisht dhe kësisoj nuk ka pasur të drejtë për t'u dëgjuar. Praktika e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 437, pika 3, të KPP-së, bie ndesh me nenet 28, 31, 33 dhe 42 të Kushtetutës, si e tillë duhet të deklarohet antikushtetuese. Kjo ka sjellë edhe cenimin e së *drejtës së aksesit* të tij në atë gjykatë.

13.1.3. *E drejta për gjykim të drejtë dhe publik*, pasi vendimmarrja e gjykatave është e pavlefshme. Gjykata e Lartë nuk e ka regjistruar me audio seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomën e këshillimit, ndaj ka dyshime të qenësishme mbi njëanshmërinë e saj. Procesverbali është absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk përmban asnjë nga elementet e detyrueshme të parashikuar në nenet 115 dhe 116 të KPP-së dhe ndonëse përfshin edhe dispozitivin, është më pak se një faqe dhe është nënshkruar vetëm nga sekretarja dhe kryesuesi, por jo nga dy anëtarët e tjerë të kolegjit, për rrjedhojë edhe vendimi i këtij kolegji është absolutisht i pavlefshëm. Gjykata e Lartë duhet të kishte konstatuar kryesisht pavlefshmërinë e procesverbaleve të seancave gjyqësore në gjykatën e apelit në periudhën 19.12.2016–15.2.2017, ku mungon nënshkrimi i një anëtari të trupit gjykues, ndërsa procesverbalet e seancave të periudhës 9.3.2016–19.4.2016, në gjykatën e shkallës së parë nuk përmbajnë as emër dhe as funksion të nënshkruesve.

13.1.4. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi provat janë të paligjshme, sepse janë mbledhur nga kontrolli haptazi i paligjshëm i banesës. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë provat e kërkuara nga mbrojtja, ndërsa gjykata e apelit nuk ka pranuar të gjitha kërkesat e mbrojtjes, madje ajo e ka rënduar pozitën e kërkuesit, duke rritur dënimin për njërën nga veprat penale. Ky cenim është thelluar edhe më tej nga Gjykata e Lartë,

e cila nuk ka njoftuar as kërkuesin, as mbrojtësin e tij.

13.1.5. *Standardi i arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pretendimet thelbësore të kërkuesit me natyrë kushtetuese dhe procedurale, gjë e cila ka cenuar edhe të drejtën e aksesit të tij.

13.2. *Parimi i barazisë para ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi prokuroria ka pasur qëllim dashakeqës, ka treguar njëanshmëri të theksuar me synimin për ta lënë në burg atë dhe për të mbuluar veprimet e punonjësve të policisë përgjegjëse për ushtrimin e dhunës ndaj tij.

13.3. *E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues,* e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, pasi kërkuesi ka qenë subjekt i torturave dhe trajtimit çnjerëzor, veprimeve të paligjshme dhe të dënueshme si krime të rënda, duke e lënë pa kujdes mjekësor 7 ditë dhe pa i mundësuar kontaktin me familjarët.

13.4. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë përmbushur detyrimin për të verifikuar dhe vërtetuar fajësinë përtej një dyshimi të arsyeshëm. Hetimi nuk ka qenë i plotë, i paanshëm, në respektim të garancive procedurale dhe dyshimet nuk janë vlerësuar në favor të kërkuesit.

14. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument se ku qëndron ky cenim, por ka trajtuar vetëm vlerësimin e provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Vetëm referimi në dispozitat kushtetuese është i pamjaftueshëm për të konstatuar shkeljen, për rrjedhojë kërkesa nuk plotëson kriteret për pranueshmërinë e saj, sipas neneve 27, pika 2, shkronja "d" dhe 48, të ligjit nr. 8577/2000.

14.2. Pretendimet kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe vlerësimit të provave e zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, e si të tilla ato dalin jashtë juridiksionit kushtetues.

II
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

15. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "i", të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis,* bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor që është përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 24.11.2022, ndërsa ankimin kushtetues individual e ka paraqitur në datën 22.3.2023, në të cilin ka parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për

proces të rregullt ligjor në disa aspekte, së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë. Për rrjedhojë, ai legjitimohet *ratione temporis* për këto pretendime, pasi i ka paraqitur brenda afatit ligjor 4- mujor.

19. Gjykata konstaton se në aktin e parashtrimeve shtesë të datës 14.7.2023, kërkuesi, ndër të tjera, ka kërkuar shfuqizimin e neneve 436, pika 2 dhe 437, pika 3, të KPP-së, duke shtuar kështu objektin e ankimit. Për këtë kërkim, ai ka paraqitur si shkak cenimin e të drejtave për t'u njoftuar, dëgjuar dhe mbrojtur, pretendime të cilat nuk i ka ngritur në ankimin fillestar. Nga përmbajtja e kombinuar e neneve 1, pika 2 dhe 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, si dhe nenit 185, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), rezulton se kërkuesi, në çdo fazë të gjykimit kushtetues, ka të drejtë të shtojë objektin e ankimit kushtetues, por pa ndryshuar njëkohësisht edhe shkaqet e tij. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se kërkimi për shfuqizimin e dispozitave ligjore shton njëkohësisht objektin dhe shkaqet e ankimit fillestar, ndaj përbën çështje të re, të paraqitur përtej afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi ka paraqitur edhe disa pretendime të tjera që lidhen me cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e parimit të gjykatës së pavarur, të paanshme dhe të krijuar me ligj, për shkak të mozbatimit nga Gjykata e Lartë të rregullave ligjore të shortit, caktimit të seancës në dhomën e këshillimit, njoftimit për kohën e seancës me afishim në ambientet fizike dhe faqen zyrtare; së drejtës për akses; së drejtës për gjykim të drejtë dhe publik; standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Këto pretendime janë paraqitur prej kërkuesit për herë të parë në aktin e parashtrimeve shtesë të datës 14.7.2023 dhe, si të tilla, përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues. Referuar nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 185, të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime të reja nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesi pasi Mbledhja e Gjyqtarëve kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare.[4]

21. Lidhur me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e të tri gjykatave janë rrjedhojë e një procesi gjyqësor të parregullt për shkak të cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe parimeve të barazisë përpara ligjit dhe prezumimit të pafajësisë, të garantuara nga nenet 42, 31, 18 dhe 30 të Kushtetutës. Gjithashtu, ai ka pretenduar se i është cenuar edhe e drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës.

22. Gjykata evidenton se këto pretendime hyjnë në juridiksionin e saj, ndaj bazueshmëria e tyre do të analizohet në vijim. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se kur vlerësimi i provave dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues *(shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 17, datë 23.2.2023; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese).* Për këtë arsye, nuk qëndron prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, se argumentet e kërkuesit nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke mbajtur në konsideratë se, në thelb, kërkuesi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë vërtetuar fajësinë e tij përtej dyshimit të arsyeshëm dhe se provat e prokurorisë synonin të mbulonin dhunën e ushtruar ndaj tij, si dhe faktin se ankimi kushtetues ka në objektin e tij vetëm procedimin penal të fajësisë së kërkuesit, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuesit nën këndvështrimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

23. Kërkuesi ka pretenduar se prokurorja e çështjes, në datën 6.10.2015, pas 3 muajsh e 1 dite nga arrestimi i tij, ende nuk e kishte pyetur në cilësinë

[4] Gjyqtarja Elsa Toska votoi për pranimin e parashtrimeve shtesë të kërkuesit, edhe pse janë shkaqe të reja, me argumentet se: i. pretendimet janë brenda objektit dhe bazës kushtetuese të përcaktuar në ankimin kushtetues individual të kërkuesit; ii. mohimi i aksesit në lidhje me pretendimet e reja të kërkuesit në gjykimin kushtetues, si rregull, nuk mund të mbështetet në dispozitat e KPC-së, por vetëm si përjashtim; iii. jurisprudenca kushtetuese nuk e ka pasur të kufizuar shqyrtimin e pretendimeve/shkaqeve të reja të individit deri në fazën e vendimmarrjes së kalimit të çështjes në seancë plenare, ndaj edhe ky interpretim i shumicës e ngushton aksesin substancial të individit.

e të pandehurit e megjithatë ajo ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor edhe për 3 muaj të tjerë, me qëllim kryerjen e një akti ekspertimi shtesë mbi lëndën e sekuestruar në qeset plastike, pavarësisht se kishte një përgjigje nga një akt ekspertimi i mëparshëm se lënda nuk ishte narkotike ose psikotrope e ndaluar nga ligji. Ndërkohë, kërkesa e prindërve të kërkuesit për përjashtimin dhe zëvendësimin e prokurores së çështjes është rrëzuar nga drejtuesi i prokurorisë. Në datën 5.1.2016, prokurorja e çështjes ka vendosur sërish zgjatjen e afateve të hetimit edhe 2 muaj të tjerë, duke e çuar afatin e hetimit në 8 muaj gjithsej, me argumentin se ende nuk kishte ardhur përgjigjja e aktit të ekspertimit shtesë. Sipas kërkuesit, drejtuesi i prokurorisë ka qenë nën shoqërinë e drejtuesit të policisë që e kishte dhunuar dhe torturuar atë dhe ndaj të cilit Avokati i Popullit kishte rekomanduar fillimin e hetimeve për veprën penale të torturës. Po kështu, sipas tij, nuk ka rezultuar e provuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, pronësia e ndërtesës ku janë gjetur armët është e babait të tij dhe ndërtesa është larg banesës. Ai nuk është mbajtës i armëve të gjetura, në mbështjellëset e tyre nuk janë gjetur gjurmë papilare të tij ose babait të tij, nuk janë marrë gjurmët daktiloskopike për të bërë të mundur identifikimin e autorit dhe gjetja e tyre në formë të ambalazhuar e të rreshtuar në tavolinë, tregon se ato janë vendosur nga Policia e Shtetit. Ato janë gjetur gjatë një kontrolli të kryer në kundërshtim me ligjin, që nuk është kryer me vendim gjykate dhe përtej kushteve të flagrancës.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument se ku qëndron ky cenim, por ka trajtuar vetëm vlerësimin e provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Sipas tij, vendimet gjyqësore nuk mund të cenohen, pasi pretendimet lidhen me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit, që janë detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

25. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

26. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime *(shih vendimet nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 19, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në lidhje me provat, Gjykata ka evidentuar dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit kushtetues, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo për vlerësimin e tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj. Megjithatë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë detyrimin që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 9, datë 28.4.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar në mënyrë konstante se në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve

kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme *(shih vendimet nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 65, datë 16.10.2017; nr. 58, datë 24.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se ky detyrim buron edhe nga neni 15 i Kushtetutës, sipas të cilit organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

29. Në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, Gjykata thekson se garancitë kushtetuese të tij janë konkretizuar në rregullat e KPP-së, duke i krijuar në këtë mënyrë të gjitha mundësitë organit që procedon me ndjekjen penale (prokurorisë dhe gjykatave) për të përmbushur detyrën kushtetuese të respektimit të këtij parimi. Kështu, parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 4 të këtij kodi, sipas të cilit i pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të tij. Vendimi i fajësisë jepet nga gjykata kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nenet 149 e vijues kanë parashikuar rregulla të detajuara për kuptimin, marrjen dhe vlerësimin e provave. Gjykata vendos për marrjen e provës, pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj. Sipas nenit 151 të KPP-së, gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në të, kurse në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Ndërsa neni 152, po aty, përcakton se çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre dhe se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi dhe se ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

30. Nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, për të vlerësuar nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, në vijim, do të analizojë nga pikëpamja kushtetuese se si ato i kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga KPP-ja në këtë drejtim. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se në datën 5.7.2015, një numër i lartë i forcave të Policisë së Shtetit dhe atyre speciale kanë ushtruar kontroll në banesën e kërkuesit me qëllim arrestimin e një të dyshuari për vrasje. Gjatë kontrollit, punonjësit e policisë kanë ushtruar dhunë ndaj kërkuesit. Sipas deklarimeve të policisë, kërkuesi nuk i është bindur thirrjes për të hapur derën e banesës dhe se në ambientet e jashtme të saj janë gjetur armë dhe mjete të tjera të paligjshme, të cilat janë sekuestruar. Ndërsa, sipas kërkuesit, shkaku i dhunës lidhej me faktin se punonjësit e policisë kanë gabuar personin që kërkonin të arrestonin, duke menduar se ai ishte personi i dyshuar.

31. Avokati i Popullit, me anë të përfaqësuesve të tij, përgjatë periudhës 11.7.2015–24.7.2015 ka verifikuar ngjarjen. Në datën 13.7.2015 ata kanë kontaktuar kërkuesin në ambientet e paraburgimit dhe kanë konstatuar se, edhe pse kishin kaluar 7 ditë, kishte ende shenja dhune në fytyrë dhe trup, gjendje të rënduar psikologjike dhe kërkonte ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për të vërtetuar dhe dëshmuar dhunimin, të cilin e konsideronte torturë. Avokati i Popullit ka konstatuar se burgu në të cilin mbahej kërkuesi nuk kishte administruar asnjë shënim në regjistrin e komisionit të pritjes lidhur me shenjat e dhunës shkaktuar nga ana e policisë. Gjithashtu, nuk ishte kryer vizitë mjekësore dhe nuk ishte hapur kartelë mjekësore nga ana e personelit mjekësor të burgut, ndërkohë që në dokumentet shoqëruese të policisë të dosjes penale të kërkuesit figuronte një kartelë vizite mjekësore nga komisariati, e cila evidentonte se në datën 6.7.2015, ai ishte diagnostikuar me laceracione në pjesë të ndryshme të trupit dhe ishte trajtuar me mjekim ambulator nga mjeku i komisariatit. Në vijim, pas marrjes edhe të dëshmive të familjarëve dhe personave të tjerë që kishin dijeni për ngjarjen, Avokati i Popullit ka kërkuar kryerjen e ekspertimit nga mjeku ligjor, i cili megjithëse ishte paraqitur në ambientet e burgut në datën 15.7.2015, ishte penguar nga drejtuesit e institucionit, duke e ekzaminuar kërkuesin vetëm në datën 23.7.2015. Në përfundim të hetimit administrativ, Avokati i Popullit ka konkluduar se deklarimet mohuese të punonjësve të policisë se kërkuesi nuk ishte dhunuar prej tyre rrëzoheshin nga provat e administruara, sikurse deklarimet e 9 shtetasve, dy fotografitë e bëra gjatë kohës që ai ishte nën mbikëqyrjen e policisë, si dhe nga kartela ditore e ndihmësmjekut të komisariatit. Kjo sjellje ndaj tij nga punonjësit e policisë, duke e goditur me shkelma, grushte, qytë automatiku, dorëza pistolete dhe bisht sëpate, përbënin trajtim çnjerëzor sipas Avokatit të Popullit.

32. Ndërkohë, kontrolli i banesës i datës 5.7.2015 është dokumentuar me procesverbal, në të cilin janë pasqyruar sendet e sekuestruara në ambientin pranë banesës. Procesverbali i kontrollit është nënshkruar pa vërejtje nga kërkuesi dhe e ëma e tij, si dhe mban shënimin se të dy këta persona, pasi u pyetën nëse kishin fshehur prova materiale ose sende të veprës penale, kanë deklaruar se nuk kishin. Po kështu, e ëma e kërkuesit ka dhënë deklarime gjysmë ore pas kontrollit, duke mbajtur qëndrimin se nuk kishte dijeni se kujt i përkisnin armët e gjetura dhe se kush mund t'i kishte fshehur ato në ambientin (magazinë) që përdorej nga familja për materialet e punës. Sendet e sekuestruara me cilësinë e provave materiale kanë shërbyer për regjistrimin e procedimit penal nr. 1135, datë 6.7.2015 dhe kërkuesi është proceduar nën masën e sigurimit të arrestit në burg.

33. Lënda e gjetur në qeset plastike i është nënshtruar ekspertimit kimik dhe ekspertët janë shprehur se nuk mund të përcaktonin nëse ishte lëndë narkotike apo psikotrope. Mbi bazën e këtij ekspertimi, në datën 29.1.2016 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes që lidhej me veprën penale "Prodhimi dhe shitje e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283 të KP-së, me arsyetimin se kryerja e kësaj vepre penale nga kërkuesi ishte e dyshimtë. Në të njëjtën datë, prokuroria ka vendosur marrjen e kërkuesit në cilësinë e të pandehurit për veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve të ftohta dhe armëve të gjuetisë, të parashikuara nga nenet 278, paragrafi i tretë, 279, paragrafi i parë dhe 280 të KP-së. Sipas prokurorisë, akuzat provoheshin nga dy procesverbalet e datës 5.7.2015 për kontrollin e banesës dhe ambienteve përreth saj, të shoqëruar me tabelë fotografike, procesverbali i datës 5.7.2015, i sekuestrimit të provave materiale dhe tre aktet e ekspertimit të datës 7.7.2015, mbi gjendjen teknike të armëve të sekuestruara. Në vijim, në datën 15.2.2016 prokuroria ka dërguar kërkesën në gjykatë për gjykimin e çështjes penale.

34. Gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi ka mohuar akuzën dhe ka kërkuar drejtësi, duke pretenduar se hetimi ishte i paplotë. Sipas tij, prokuroria nuk kishte hetuar për gjurmët daktiloskopike mbi ambalazhin e sendeve të sekuestruara për t'i krahasuar me ato të kërkuesit, që do të provonin se ai nuk ishte autor i veprave penale. Prokurorja e çështjes ka pohuar se kjo rrethanë nuk është hetuar. Në seancën e datës 24.3.2016 gjykata ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit daktiloskopik për të verifikuar ekzistencën e gjurmëve papilare në sendet e sekuestruara dhe krahasimin e tyre me ato të kërkuesit. Eksperti i caktuar nga gjykata ka pohuar në seancën e datës 19.4.2016 se armët i ishin nënshtruar ekzaminimit teknik të tyre dhe për këtë shkak ishin prekur edhe nga persona të tjerë pas sekuestrimit, ndaj ekspertimi ka rezultuar i pamundur.

35. Në përfundim të gjykimit në shkallë të parë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 28.7.2016 e ka deklaruar fajtor kërkuesin dhe e ka dënuar atë me dy vjet e katër muaj burgim, me arsyetimin se akuzat ndaj tij provoheshin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas asaj gjykate, koncepti i "banesës" lidhet me "posedimin", si pushteti fizik i një personi mbi një send të caktuar. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, armëve të ftohta dhe armëve të gjuetisë hyjnë në kategorinë e veprave penale me përgjegjësi objektive, mjafton që ato të gjenden në banesë, ku i pandehuri ka pushtetin fizik mbi armët. Në këto rrethana, shprehet gjykata e shkallës së parë, organi i akuzës konsiderohet se ka shlyer barrës e provës dhe i takon personit që gjendet në banesë të provojë të kundërtën, se pikërisht armët e gjetura nuk janë mbajtur prej tij, dhe se në rastin konkret, ai nuk dha ndonjë version bindës se armët nuk janë të tijat. Sipas gjykatës, fajësia e kërkuesit provohet nga disa rrethana: vendi ku u gjetën armët ishte i mbyllur dhe frekuentohej nga familja e kërkuesit; kryefamiljari (babai i kërkuesit) nuk ishte në shtëpi kur banesa u kontrollua nga policia; kërkuesi ishte personi që nuk ia hapi derën e shtëpisë punonjësve të policisë që ishin në ndjekje të një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore; rezistenca e kërkuesit për t'i hapur derën policisë ishte bërë me qëllim që armët të mos gjendeshin nga policia (*shih faqen 11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*).

36. Në apelin e paraqitur kundër këtij vendimi, kërkuesi ka pretenduar sërish se nuk është arritur të vërtetohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet; punonjësit e policisë e kanë rrahur në mënyrë çnjerëzore, pa asnjë lloj motivi dhe se ai e familja e tij as kanë pasur dhe as kanë lidhje me akuzat; Avokati i Popullit ka rekomanduar fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të

policisë për veprën penale të torturës; babai i tij ka pohuar se edhe pse banesa ku janë gjetur armët është në pronësi të tij, ato nuk kanë qenë as të tijat, as të djalit dhe se nuk rezulton të jenë kërkuar dhe verifikuar gjurmët papilare mbi ambalazhin e sendeve të sekuestruara.

37. Gjykata e Apelit Shkodër, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, në datën 15.2.2017, ka vendosur lënien në fuqi të fajësisë së kërkuesit për dy prej akuzave, duke pushuar çështjen penale për akuzën e armëve të gjuetisë për shkak të dhënies së amnistisë me ligj. Ajo ka konfirmuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se barra e provës i takon kërkuesit, si personi i gjendur në banesë gjatë kryerjes së kontrollit. Sipas saj, nënshkrimi i procesverbalit pa vërejtje prej kërkuesit dhe nënës së tij është një provë e qartë e fajësisë, ndërsa ushtrimi i dhunës fizike nga punonjësit e policisë nuk është fakt që e shkarkon kërkuesin nga përgjegjësia penale. Gjykata e apelit ka evidentuar, gjithashtu, se për faktin e dhunës është filluar procedimi penal mbi kërkesën e Avokatit të Popullit dhe çështja është në hetim.

38. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke parashtruar, ndër të tjera, edhe cenimin e prezumimit të pafajësisë. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 24.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se gjykatat e faktit, në zbatim të nenit 152 të KPP-së, kanë vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë nga provat, të cilat janë administruar në gjykim. Sipas saj, gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe ka trajtuar pretendimet e parashtruara në ankim, duke i dhënë zgjidhje çdo pretendimi të bërë nga ana e kërkuesit. Gjykata e Lartë ka cituar në arsyetimin e vendimit qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për parimin e prezumimit të pafajësisë, duke nxjerrë konkluzionin se në rastin e kërkuesit gjykatat e faktit nuk e kanë filluar procesin me bindjen se ai është fajtor, ndaj ato nuk e kanë shkelur këtë parim.

39. Duke analizuar faktet e mësipërme, Gjykata vëren se fillimisht prokuroria, dhe më pas dy gjykatat e faktit, në deklarimin e fajësisë së kërkuesit janë bazuar në 3 rrethana specifike: i. prania e kërkuesit gjatë ushtrimit të kontrollit të banesës dhe ambienteve rrethuese të saj; ii. gjetja dhe sekuestrimi i armëve në ambientet e jashtme të banesës; iii. gjendja teknike e armëve, sipas akteve të ekspertimit dhe mungesa e lejes për mbajtjen e tyre. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykatat e faktit kanë çliruar prokurorin nga barra e provës, duke ia kaluar kërkuesit detyrimin për të provuar se armët e sekuestruara nuk i përkisnin atij, me arsyetimin se përgjegjësia penale e veprave penale të mbajtjes së armëve ka natyrë objektive. Me fjalë të tjera, gjykatat e faktit kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit me anë të prezumimeve të faktit.

40. Për të vlerësuar kushtetutshmërinë e qëndrimit të tyre, Gjykata i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, sipas së cilës Konventa nuk i ndalon prezumimet ligjore ose të faktit në çështjet penale. Megjithatë, prezumimet duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes (*shih vendimet e GJEDNJ-s-Salabiaku kundër Francës, 7 tetor 1988, §§ 27–28 dhe Radio Franca dhe të tjerët kundër Francës, 30 mars 2004, § 24*). Nën këndvështrimin e këtij standardi, Gjykata çmon se edhe pse ruajtja e rendit dhe sigurisë publike nga armët është një interes i rëndësishëm, në rastin konkret prezumimet e faktit nuk rezultojnë të arsyeshme dhe nuk kanë respektuar të drejtat e mbrojtjes së kërkuesit. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban në konsideratë, nga njëra anë, se prezumimi i faktit konkret është i diskutueshëm dhe, nga ana tjetër, rrethanat mbizotëruese të çështjes janë të tilla që lidhen me dhunën e ushtruar ndaj kërkuesit dhe me cilësinë e hetimit penal.

41. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton, *së pari*, se përgjegjësia objektive e kërkuesit për mbajtjen pa leje të armëve në një ambient të jashtëm të banesës është një prezumim fakti i diskutueshëm në kushtet kur armët janë gjetur në një ambient të jashtëm të banesës dhe kur ai nuk jeton vetëm në banesë. Megjithëse sendet janë sekuestruar në ambientin magazinë që përdorej për nevoja pune nga familja dhe kryefamiljar ishte babai i kërkuesit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin e fajësisë së kërkuesit me arsyetimin jo bindës se "*babai i kërkuesit nuk ka qenë në vendngjarje kur është kryer kontrolli i banesës*".

42. *Së dyti*, Gjykata vëren se prokuroria dhe gjykatat e faktit nuk kanë kryer verifikimin e duhur të dhunës së ushtruar ndaj kërkuesit prej punonjësve të policisë gjatë kontrollit të banesës, ndonëse kishin prova dokumentare të vëna në dispozicion nga

Avokati i Popullit (*shih paragrafin 31 më sipër*). Qëndrimit mohues të kërkuesit për akuzat, si dhe pretendimeve dhe provave të tij për dhunën e ushtruar nga Policia e Shtetit, gjykatat u janë përgjigjur se ato ishin objekt i një procedimi tjetër penal. Duke vepruar në këtë mënyrë, arsyetimi i gjykatave të faktit se procesverbali i kontrollit të banesës ishte provë për fajësinë e kërkuesit, pasi ishte nënshkruar pa vërejtje nga kërkuesi dhe e ëma e tij, pa u ndalur në analizën e faktit se procesverbali ishte nënshkruar menjëherë pas dhunimit të kërkuesit, nuk është bindës. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ndodhen para pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për veprime të paligjshme të organeve që procedojnë me ndjekjen penale, ato kanë detyrimin të ndërmarrin hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes (*shih vendimin nr. 14, datë 3.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. *Së treti,* duke njohur rolin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në përcaktimin e fakteve, bazuar në provat e shqyrtuara rregullisht, Gjykata konstaton se prokuroria dhe gjykatat e faktit kanë pranuar me fuqi të plotë provuese procesverbalin e kontrollit të banesës, të nënshkruar pa vërejtje nga kërkuesi dhe e ëma e tij, pa dhënë asnjë shpjegim përse e ëma e kërkuesit, e pyetur edhe si deklaruese pas gjysmë ore nga kontrolli, ka mohuar faktin që armët e gjetura i përkasin kërkuesit apo familjarëve të tjerë. Po kështu, prokuroria nuk ka verifikuar pretendimet e kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake, konkretisht për të hetuar ekzistencën e gjurmëve papilare mbi sendet e sekuestruara dhe eventualisht për t'i krahasuar ato me të kërkuesit. Ndonëse gjykata e shkallës së parë ka vepruar për verifikimin e këtij pretendimi, gjatë gjykimit ky ekspertim ka rezultuar i pamundur (*shih paragrafin 34 më sipër*).

44. Gjithashtu, Gjykata vëren se ndonëse kërkuesi i ka parashtruar pretendimet e tij në rekurs, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos e riparuar qëndrimin e gjykatave të faktit. Ajo iu është përgjigjur pretendimeve të kërkuesit me arsyetim të kufizuar dhe formal se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk parashikoheshin nga ligji. Kështu, Gjykata e Lartë, megjithëse shpjegon në arsyetimin e saj parimin e prezumimit të pafajësisë, duke përdorur për këtë qëllim edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, nuk rezulton ta ketë zbatuar atë në rrethanat e çështjes konkrete, duke u mjaftuar me shprehjen formale se "*nuk rezulton që gjykatat të kenë filluar procesin me bindjen se i pandehuri është fajtor dhe të jetë shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë në të gjitha elementet e tij*" (*shih fjalinë e fundit të paragrafit 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po ashtu, pretendimeve për dhunën e ushtruar, për cilësinë e dobët të hetimit dhe mosveprimit për marrjen e provave të domosdoshme, Gjykata e Lartë u është përgjigjur se janë haptazi të pabazuara, pasi lidhen me vlerësimin e provave që dalin jashtë fokusit ekskluzivisht ligjor të saj dhe se gjykata e apelit iu ka dhënë përgjigje atyre (*shih paragrafët 16-18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit, të cilat kanë dështuar në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm dhe të domosdoshëm për të sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes që lidheshin me pretendime dhe dyshime serioze faktike për veprime të paligjshme të Policisë Gjyqësore që ka proceduar me ndjekjen penale të kërkuesit.

45. Për sa më lart, Gjykata rithekson se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për të detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, për të siguruar respektimin e standardeve kushtetuese (*shih vendimin nr. 83, datë 26.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta kryer vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në vlerësim tërësor të elementeve të mësipërme, Gjykata çmon se, fillimisht, prokuroria dhe, më pas, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në rastin e kërkuesit nuk rezulton ta kenë filluar procesin me prezumimin se ky i fundit nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Në vijim, arsyetimi i vendimeve të gjykatave nuk dëshmon që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërsa, Gjykata e Lartë nuk ka kryer rol aktiv për të ndikuar efektivisht në vendimmarrjen e gjykatave të faktit për të synuar të drejtën dhe për të riparuar qëndrimin e tyre, me qëllim që të respektoheshin standardet kushtetuese. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për

cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar.

47. Së fundmi, edhe pse kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të të tria shkallëve, Gjykata çmon se duhet të shfuqizohet vetëm vendimi nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, i Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim pranë saj. Gjykata e Lartë, duke u bazuar në kompetencat si gjykatë ligji, është në pozicionin e duhur për të shqyrtuar pretendimet e kërkuesit dhe për t'i dhënë përgjigje atij në përputhje me të drejtat kushtetuese, si dhe për të riparuar gabimet e gjykatave më të ulëta.

48. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2023.
Shpallur më 20.12.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi
Anëtar kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Maringlen Gjuraj, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 786 (3491), datë 28.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 113, datë 15.2.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-1526, datë 24.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe/ose kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me tjetër trup gjykues*", jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësoj se ajo duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Nga shqyrtimi kushtetues i çështjes rezulton se kërkuesi është hetuar në kuadër të procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale të parashikuara nga nenet 278, paragrafi i tretë, 279, paragrafi i parë dhe 280 të KP-së. Procedimi është mbështetur në faktin se gjatë operacionit policor të ushtruar në kuadër të arrestimit të një të dyshuari për vrasjen e dy shtetasve të huaj është kontrolluar edhe banesa e kërkuesit, ku në një objekt njëkatësh, të ndodhur në oborrin prapa saj, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale armë dhe municione.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 28.7.2016, ka vendosur deklarimin fajtor të tij për veprat penale sipas akuzës dhe e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e datës 15.2.2017, i cili ka ndryshuar masën e dënimit për veprën penale të prodhimit, mbajtjes, blerjes apo shitjes pa leje të armëve të ftohta dhe e ka pushuar atë për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive, për shkak të amnistisë së dhënë me ligjin nr. 141/2016. Mbi bazën e rekursit të kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 24.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

4. Ndaj vendimeve të tri gjykatave, kërkuesi ka ushtruar ankim kushtetues individual me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregull ligjor e lidhur me parimin e barazisë së

armëve dhe kontradiktoritetin, parimi i barazisë përpara ligjit dhe prezumimit të pafajësisë, si dhe e drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, të garantuara, respektivisht, nga nenet 42, 31, 18, 30 dhe 25 të Kushtetutës.

5. Shumica ka vlerësuar se këto pretendime hyjnë në juridiksionin e saj dhe duke mbajtur në konsideratë se, në thelb, kërkuesi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë vërtetuar fajësinë e tij përtej dyshimit të arsyeshëm dhe se provat e prokurorisë synonin të mbulonin dhunën e ushtruar ndaj tij, si dhe faktin se ankimi kushtetues ka në objektin e tij vetëm procedimin penal të fajësisë së kërkuesit, i ka shqyrtuar ato nën këndvështrimin e parimit të prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Më tej, shumica ka evidentuar se gjykatat e faktit kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit me anë të prezumimeve të faktit (*shih paragrafin 39 të vendimit*). Sipas shumicës, Gjykata e Lartë nuk e ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit, të cilat kanë dështuar në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm dhe të domosdoshëm për të sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes që lidheshin me pretendime dhe dyshime serioze faktike për veprime të paligjshme të Policisë Gjyqësore që ka proceduar me ndjekjen penale të kërkuesit (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Në përfundim, gjyqtarët e shumicës kanë konkluduar se pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar, pasi në vlerësimin tërësor të elementeve të çështjes, fillimisht, prokuroria dhe, më pas, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në rastin e kërkuesit nuk rezulton ta kenë filluar procesin me prezumimin se ky i fundit nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Në vijim, arsyetimi i vendimeve të gjykatave nuk dëshmon që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka kryer rol aktiv për të ndikuar efektivisht në vendimmarrjen e gjykatave të faktit për të synuar të drejtën dhe për të riparuar qëndrimin e tyre, me qëllim që të respektoheshin standardet kushtetuese (*shih paragrafin 46 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës, pasi vlerësoj se jo vetëm prokuroria dhe gjykatat e faktit kanë ushtruar kompetencat e tyre në drejtim të vërtetimit të fajësisë së kërkuesit, por edhe Gjykata e Lartë ka vepruar brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues si gjykatë e ligjit, duke i dhënë përgjigje kërkuesit në mënyrë shteruese, për rrjedhojë duke përmbushur standardet kushtetuese të elaboruara nga Gjykata për këtë qëllim.

7. Në mbështetje të qëndrimit tim sjell në vëmendje qasjen që Gjykata ka mbajtur në jurisprudencën e saj për interpretimin e prezumimit të pafajësisë, sipas së cilës, deklarimi i fajësisë së të pandehurit duhet të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim dhe i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, mospranimi i rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, por është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimin nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 14, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*)

8. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, konstatoj se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se fajësia e kërkuesit provohet nga disa rrethana, duke i evidentuar ato mjaftueshëm. Nga ana tjetër, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë për sa më sipër, qëndrim i cili është konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk e ka pranuar rekursin e kërkuesit. Kjo e fundit ka vlerësuar se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar dhe zgjidhje çdo pretendimi të kërkuesit dhe se gjykatat e faktit nuk e kanë filluar procesin me bindjen se ai është fajtor, ndaj nuk e kanë shkelur këtë parim në të gjitha elementet e tij, ndërsa çështja e vlerësimit të provave del jashtë fokusit të kontrollit rishikues ekskluzivisht ligjor të saj.

9. Për sa më lart, vlerësoj se gjykatat e faktit kanë përcaktuar në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet dhe ligjin e zbatueshëm që kanë çuar në vendimmarrjen e tyre, ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme se kjo vendimmarrje ka qenë e drejtë dhe rekursi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji. Siç ka theksuar edhe Gjykata, edhe një arsyetim i kufizuar i Gjykatës së Lartë përmbush standardet kushtetuese të zbatueshme, sidomos kur konstaton që gjykatat më ulëta kanë zbatuar drejt ligjin. Përkundrejt pretendimeve të kërkuesit dhe

vlerësimit të shumicës, çmoj se deklarimi fajtor dhe dënimi i tij janë mbështetur mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e të vlerësuara nga gjykatat në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Po kështu, kërkuesit, nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur rregullisht prej tij, i është dhënë mundësia të kundërshtojë provat e paraqitura nga organi i akuzës, si dhe të paraqesë provat në mbështetje të pretendimeve të tij për pafajësi. Në këtë kuptim, konstatoj se procesi i zhvilluar nga gjykatat është realizuar pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, duke garantuar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në procesin penal. Në mendimin tim, përveç pretendimeve të kërkuesit, nuk rezulton ndonjë e dhënë që të tregojë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë filluar procesin me paragjykimin se ai i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

10. Nga ana tjetër, çmoj të evidentoj se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për shpalljen ose jo fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat ai akuzohet, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Po kështu, ndonëse rekursi i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, ajo gjykatë nuk ka kryer vetëm një konstatim formal të paraqitjes së shkaqeve të tij, por edhe vlerësim të vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta objekt kundërshtimi në rekurs, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore penale të kërkuesit. Në rastin konkret, Kolegji Penal i asaj gjykate ka krijuar bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi kanë qenë të pabazuara në dispozitat përkatëse ligjore, pasi, sipas saj, gjykatat e faktit kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimeve të kundërshtuara. Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar që gjykatat më të ulëta të kishin nisur gjykimin e çështjes me paragjykim apo se provat e administruara gjatë procesit të ishin të paplota apo të paqarta për të konkluduar në fajësinë dhe dënimin e kërkuesit.

11. Për sa më lart, vlerësoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar dhe se procesi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, në tërësi, plotëson standardet kushtetuese të gjithëpranuara, prandaj, në rastin konkret, Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Sonila Bejtja

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 189
Datë: 2023/12/27 15:05:17
428cdcb6-b9bf-4ef8-a02a-ff19155e1ff7

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë